



Ndihmoni fëmijës suaq që të mësojë si të sillen

Fëmijët mësojnë si të sillen

Të gjithë fëmijët janë të veçantë, sepse të gjithë lindin me karakterin e tyre të veçantë. Pikërisht për këtë edhe fëmijët e një familjeje të njëjtë nuk reagojnë njësoj në situata të ndryshme. Por, një pjesë e madhe e sjelljes së fëmijëve të vegjël mësohet nga përvoja. Ata mësojnë nga ajo se si reagojnë të rriturit ndaj tyre kur sillen mirë ose jo aq mirë. Ata po ashtu i kopjojnë nga të rriturit edhe mënyrat e sjelljes – edhe “të keqen” edhe “të mirën”. Fëmijët nuk i imitojnë vetëm fëmijët e tjerë.

Fëmijët e vegjël kanë nevojë për ndihmë nga të rriturit që të krijojnë shprehje të sjelljes së mirë dhe durim nga ju kur bëjnë gabime. Do të ketë periudha kur ata do ta dinë se çka duhet të bëjnë dhe do të synojnë ta bëjnë atë. Në ato momente do t’u duhet mbështetje e madhe, njësoj siç u duhet ndihmë kur nuk mund ta krijojnë kullën e tyre nga katrorët ose kur duhet të mbushin lëng. Që t’i përvetësojnë këto shkathtësi, fëmijët kanë nevojë për kohë dhe për ushtrim. Por, ushtrimi është po ashtu i nevojshëm edhe atëherë kur fëmijët mësojnë si të sillen.

Bëhuni i qartë se çka dëshironi

Fëmijët kanë nevojë për kufizime dhe rregulla që ua vendosin të rriturit, por ato gjëra nuk duhet të ndryshojnë sipas disponimit të të rriturve. Personat e rritur që u ndihmojnë më së shumti fëmijëve të vegjël, janë ata që janë “të rreptë, por të drejtë”, të cilët do të thonë “jo” në momentet kryesore dhe çdoherë e kontrollojnë se a kanë thënë “jo” sipas shprehisë – pa menduar shumë.

Rregullat themelore nuk mund të jenë gjithnjë vetëm për atë që fëmijët nuk duhet ta bëjnë. Në rrethana të tilla fëmijëve u mbetet vetëm të mendojnë se çka guxojnë të bëjnë pas të gjitha urdhrave “pusho”. Për të gjitha “mos e bën atë” duhet të jeni i gatshëm edhe për alternativën “mundet”. Duke u prirë ju me kujdes, fëmijët e vegjël mund të mësojnë se nuk është mirë t’i godasin njerëzit, madje edhe kur janë shumë të hidhëruar me nënën e tyre ose kur ndonjë fëmijë tjetër është vërtet “i tmerrshëm”. Ata nuk do të mund ta mësojnë këtë sjellje nëse dikush nga të rriturit u bërtet vazhdimisht ose i godet dhe e përdor sjelljen e njëjtë të cilën përpiqet ta ndalojë te fëmijët.

Dhe, çka u mbetet fëmijëve të bëjnë kur janë të hidhëruar ose kur i kanë ndjenjat e lënduara? Ata kanë nevojë për ndihmë, si për shembull: “Unë jam i/e hidhëruar, sepse...”. Fëmijët e vegjël mësojnë, pak nga pak, se nëse atyre u pëlqen ndonjë libër ose qerre me të cilën luan ndonjë fëmijë tjetër, nuk është në rregull që thjesht ta grabisin atë dhe të ikin. Në vend të kësaj ata duhet të pyesin: “Të lutem, a mund ta marr...” ose të ofrojnë diçka për këmbim.

Rregullat themelore u ndihmojnë të rriturve që t'ia dalin mbanë me sfidën e goditjes fizike. Gjithnjë ka ndonjë zgjedhje tjetër me të cilën do t'i shmangeni lëndimit të fëmijëve të vegjël – qoftë emocionalisht qoftë fizikisht. Në gjendje stresi ndoshta duhet të numëroni deri në 10, të merrni frymë thellë ose të ktheheni disa hapa prapa.

Shmanguni nga etiketimi i fëmijëve

Fëmija i vogël ndonjëherë ballafaqohet me dikë duke përdorë fjalë ose aktivitete të ashpra. Por, kjo sjellje nuk e shndërron fëmijën në fëmijë “shpirtlig” ose “të keq”.

Të rriturve nuk u pëlqen nëse dikush vazhdimisht i kritikon me fjalë si: “Ti gjithnjë je i padurueshëm!” ose “Ti asnjëherë nuk më dëgjon!”. Të rriturit duhet t'i shmangen shprehisë së keqe të etiketimit të vazhdueshëm të fëmijëve, si për shembull: “Asnjëherë nuk ke qenë i këtillë” ose “Çdoherë e bën këtë”.

Përpiquni që secilin episod hidhërimi ta shihni si një ngjarje të veçantë. Në këtë mënyrë fëmijën nuk do ta shihni si njeri që ka “lindur i keq”. Duke trajtuar çdo moment të hidhërimit veçmas, ju do ta keni më lehtë ta kuptoni se çka e ka shkaktuar tërbimin dhe në të ardhmen t'i ndihmoni fëmijës t'i shmanget asaj sjelljeje.

Fokusohuni në gjërat pozitive

Përpiquni “t'i kapni” fëmijët kur janë “të mirë”. Fëmijët më së miri mësojnë kur u ofrohet inkurajim qëllimshëm për atë që e kanë bërë. Për këtë mund të përdorni fjalë, buzëqeshje dhe gjeste, siç është duartrokitja.

- Fëmijët e kuptojnë shumë më mirë rëndësinë e këmbimit kur të dëgjojnë se i rrituri u thotë “Bravo, ia dhe disa katrorë shokut tënd”. Ky shembull u jep fëmijëve më shumë informacione për dallim nga ndonjë udhëzim i papërcaktuar: “Duhet t'i ndash gjërat me të tjerët”.
- Inkurajoni për “gjërat e vogla” dhe mos prisni diçka “mjaft të madhe” që ta vëreni. Thojuni fëmijëve: “Të faleminderit që prite, je shumë i durueshëm” ose “Bravo për ty, e kuptova se je i hidhëruar. Ta shohim çka mund të bëjmë për...”
- Shpërblimet dhe dhuratat mund të përdoren, por kjo duhet të bëhet me kujdes. Nuk është shumë hap i mençur që fëmijët çdoherë të presin “kompensim” me ëmbëlsira ose diçka tjetër edhe vetëm pse kanë qenë të kujdesshëm ose që kanë kryer ndonjë shërbim.
- Mos e regjistroni secilën sjellje “të keqe” të fëmijës. Nëse nuk mund t'ia dilni mbanë me fëmijët, atëherë gjeni dhe theksoni çdo ditë tre gjëra që ata i kanë bërë.
- Të jeni të sigurt se fëmijët janë të bindur në dashurinë tuaj, pa marrë parasysh se a duhet të merreni me grindje serioze ose me kaos të madh. Përfundimisht rezistoni sprovës që të thoni: “Nuk do të dua më nëse...” Fëmijët duhet ta ndjejnë sigurinë emocionale që buron nga fjalët: “Të dua. Por, nuk më pëlqen ajo që ia bërë shokut tënd”.

Ndihmojuni fëmijëve që të ballafaqohen me tërbimin

Fëmijët kanë nevojë për të rriturit që t'u ndihmojnë kur ata të fillojnë të bërtasin dhe të grinden.

- Bëhuni gjithnjë i gatshëm që të përziheni dhe ta ndalni ashpërsinë ose lëndimin fizik ndërmjet fëmijëve. Por, rrini i qetë – me fytyrën, gjestet dhe zërin tuaj.
- Shmanguni nga supozimet për atë se cili ia filloi i pari ose cili duhet të akuzohet. Shpeshherë nuk mund të jeni të sigurt për këtë.

- Njihuni me ndjenjat e fuqishme të fëmijëve duke thënë: “E shoh që je shumë i/e shqetësuar, ndërsa e di që je i/ hidhëruar”. Atëherë mund të shtoni: “Por, nuk është në rregull që për shkak të kësaj të rriheni”. E pastaj pyeteni në mënyrë të qetë: “Çka ndodhi këtu?” ose “E shoh se ekziston problem në lidhje me biçikletën”.
- Dëgjojeni secilin fëmijë dhe ndihmoni me pyetjen: “Çka mund të bëjnë rreth problemit?” Bashkë me të do të gjeni zgjidhje më të mirë për situatën e krijuar.

Ballafaqohuni me pasojat, mos ndëshkoni

Foshnjat dhe fëmijët e vegjël nuk mund t’i parashikojnë rezultatet e aktiviteteve të tyre. Ata nuk dinë sa duhet se si funksionon bota. Prandaj shpeshherë fëmijët shumë të vegjël duhet të tërhiqen anash, sepse nuk mund të ndalohen – është sfidë shumë e madhe që të vihen sendet në video-rekoder ose të radhitet edhe një kulaçe sipër. Shpeshherë fëmijët e vegjël duhet të përkujtohen në rregullën themelore ose edhe një herë ta dëgjojnë kërkesën.

- Bëhuni i qetë (nuk është gjithnjë lehtë) dhe përkujtoni fëmijët se: “Nëse nuk mund të rrish i qetë derisa lexohet përralla, atëherë do të dalim prej këtu”. Tërheqja e vërejtjes mund të krijojë ndjenjë të “policit korrekt”. Po ashtu kjo u jep mundësi fëmijëve që të riorientohen. Atëherë mund t’u thoni “bravo” – nëse ia dalin.
- Secila pasojë duhet të ketë kuptim në raport me sjelljen e fëmijëve. Fëmijët ndjehen të mllëfosur nëse nuk shkojnë park, sepse në mëngjes janë sjellë “shumë keq”. Kjo pasojë artificiale do të duket si dënim dhe ata mund të mendojnë se: “Ti nuk je korrekt!”
- Ballafaqohuni me sjelljen e fëmijëve në momentin e njëjtë dhe atëherë do ta shmangni kthimin prapa. Mendoni për një moment se si do të ndjeheshit nëse nuk do të kishte fillim të ri kur ju keni bërë gabim.
- Pas asnjë befasi, fëmijët shpeshherë e kopjojnë atë që e kanë dëgjuar dhe parë nga të rriturit. Përpiquni që sa më mirë që mundemi t’i shmangeni secilës taktikë që do të rezultonte me qortim – nëse fëmijët janë sjellë në atë mënyrë. Të rriturit që shfrytëzojnë bërtitjen, sarkazmin, mallkimin, kërcënimin ose goditjen paraqesin shembull të keq për fëmijën.

Pse ndonjëherë e kemi vështirë?

Askush nuk është i përsosur. Madje, edhe të rriturit më të mirë lodhen, e humbin durimin dhe në një moment pa menduar shumë bëjnë gabime. Personi i rritur që është i kujdesshëm do të mendojë: “A do të dëshiroja që fëmija ta shqiptojë ose bëjë atë që unë e bëra tash?”. Nëse ka nevojë, ne duhet të themi “Më fal” dhe këtë ta presime edhe nga fëmijët.

- Të rriturit mund të kenë më pak “ditë të mira” dhe është e rëndësishme që fëmijët të mos qortohet për aktivitetin e njëjtë për të cilin një ditë më parë kanë marrë buzëqeshje. Kup-tohet, fëmijët mësojnë se ndonjëherë rregullat thyhen pak. Megjithatë, ata nuk mund të ballafaqohen me ndryshimin drastik të reagimeve të të rriturve.

Sido që të ketë qenë përvoja juaj nga fëmijëria ose qëndrimet e njerëzve që i njihni, përpiquni ta kuptoni se inkurajimi i ngrohtë nuk do t’i përkëdhelë fëmijët ose nuk do t’i bëjë arrogantë. Fëmijët më së miri mësojnë si të sillen atëherë kur u keni treguar se kanë bërë diçka të mirë dhe u keni ndihmuar që të ballafaqohen me pasojat e sjelljes.

Në përgatitjen e tekstit janë përdorë pjesë nga broshura Helping children with their behaviour, Jennie Lindon, Early Childhood edition.